



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381-38-249-873 • E-mail: fshmn@uni-pr.edu • ëëë.uni-pr.edu

FSHMN

Ref. nr. 1142

Prishtinë, Dt. 04.04.2024

RAPORT I VLERËSIMIT TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TE DIPLOMES
MASTER

| | |
|--|---|
| FAKULTETI | FSHMN |
| Departamenti/ Programi | Fizikë |
| Projektpropozimi | Analiza Sizmologjike e Lokacionit te Deponisë së Hirit në KEK për vendosjen e Paneleve Solare |
| Kandidati | Latif Hasi |
| Mentori | Prof.dr. Skënder Kabashi |
| Aprovimi i projekt propozimit në Këshillin e Fakultetit | Datë: 26.12. 2023 Vendimi nr. 7913 |
| <p>Komisioni për vlerësim të dorëshkrimit dhe mbrojtje të temës master, bazuar në Kërkesën nr.1117 të datës 22.03.2024 për temën "<i>Analiza Sizmologjike e Lokacionit te Deponisë së Hirit në KEK për vendosjen e Paneleve Solare</i>" të kandidatit Latif Hasi, në përputhje të me procedurat e rregullores së studimeve master, paraqet këtë:</p> <p style="text-align: center;">Vlerësim të dorëshkrimit</p> <p>Kandidat Latif Hasi, temën e nivelit master e ka shkruar në përputhje me kriteret akademike dhe të parapara me rregullore. Tërë materialin e ka shtri në 64 faqe, të sistemuar në 13 kapituj. Materialit i paraprinë: deklarata e betimit, falënderimi, përmbajta, abstrakti, lista e tabelave dhe lista e figurave. Ndërsa përfundon më referencat dhe shtojcën. Autori në hulumtim ka shfrytëzuar një numër të konsiderueshëm të literaturës aktuale (20), ndërsa për shtjellim të temës ka ndërtuar 8 tabela dhe 16 figura. Formulatat, tabelat dhe figurat janë kompatible me tekstin. Shtrimi dhe shtjellimi i temës është në përputhje me normat pedagogjike dhe hulumtuese. Në kapitujt fillestar janë prezantuar të dhënat gjeografike të terrenit hulumtues dhe të dhënat kryesore mbi tërmetet në atë zonë. Në kapitullin e 5-të, kandidati në hollësi ka prezantuar metodat e hulumtimit gjeofizikë. Ndërsa në kapitujt 6 dhe 7 janë prezantuar kushtet gjeologjike-</p> | |

inxhinierike dhe gjeoteknike të terrenit. Në kapitullin e 8 hollësisht është prezantuar dhe shtjelluar modeli gjeoteknik i sheshit të ndërtimit. Në kapitullin e 9 autori merret me standardit sipas EUROCODE-8. Në kapitujt 10-12 janë prezantuar rreziqet sizmike të sheshit të ndërtimit bazuar në standarde. Në kapitullin e 13 dhe të fundit janë konkludimet dhe rekomandimet. Bazuar në materialin e shtjelluar, autori ka arrit të nxjerr 10 rekomandime dhe konkludime, të cilat janë rrjedhojë e materialit të temës.

Me këtë rast kandidati Hasi ka arrit qëllim të tregoj se,

Projekt propozimi i lartshënuar jep vlerësimin e rrezikut sizmik i cili mund të kërcënojë lokacionin investues nëpërmjet metodologjisë bashkëkohore probabilitare Cornell-McGuire, dhe nga analiza e spektrave të projektimit sipas EC-8. Vlerësimi i rrezikut sizmik të lokacionit investues përcakton:

a) *Te dhënat mbi aktivitetin sizmik, sizmotektonik, intensitetin sizmik*

b) *Vlerësimet e nxitimit maksimal A_{max} dhe atij spektral S_a pre kushte trualli bedrock janë realizuar për nivel probabilitar 90% mos tejkalim për jetëgjatësi të objektit 50 vjet, që i korespondon një periudhë përsëritje të tërmetit 475 vjet dhe 95 vjet.*

c) *Rrezikun sizmik të sheshit në studim sipas Kushtit Teknik të Projektimit Antisizmik EUROCODE- 8.*

Mirëpo pavarësisht shtjellimit dhe prezantimit të mirë, komisioni mendon se me qëllim të rritjes së kualitetit prezentativ të temës, kandidati duhet të bëjë edhe:

- Lekturimin e temës
- Shkrimi të jetë me fonte të njëjtë dhe
- Të plotësohet lista e figurave me tekst nr. 15

Prishtinë, 04/04/2024

Komisioni:

1. N. Syla

/ Prof. Dr. Naim Syla – kryetar/

2. Skender Kabashi

/ Prof.Dr. Skender Kabashi – anëtar (mentor)

3. Gazmend Nafezi

/ Prof. Asoc.Dr. Gazmend Nafezi – anëtar/